



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 09, datë 12.12.2017

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIMI I RRJETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT “TELEKOM ALBANIA”
NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 4 STACIONE BAZË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Telekom Albania” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,


VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerimi i rrjetit të komunikimeve elektronike të operatorit “Telekom Albania” nëpërmjet shtimit të antenave për 4 stacione bazë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Telekom Albania” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet i Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues veçmas për secilin prej 4 stacioneve bazë, vetëm pas plotësimit të kushteve të poshtëshënuara:
 - a. Për stacionin “**Genius Building 0210**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
 - b. Për stacionin “**Gjiri i Lalzit 1610**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
 - c. Për stacionin “**Vlora Bulevard 1611**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
 - d. Për stacionin “**Lezha 1606**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Lezhë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

